

## Mehmet (Zekë) Zekaj

(17.01.1981, shqiptar nga Junik/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, i papunë, i pamartuar)

Mehmeti ka aderuar në UÇK në muajin mars të vitit 1998. Në datën **29.07.1998**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin **Junik** me granata nga pozicioni i *Lugut të Gështenjave/Dolina kestenova*, Mehmeti gjendej në oborrin e shtëpisë së vet me axhën Tafën. Njëra prej predhave e ka qëlluar murin e shtëpisë, u kthye dhe e qëlloi Mehmetin, duke e lënë të vdekur në vend. Tafa vetëm u plagos. Mehmetin e varrosën po atë ditë në varrezat e Junikut/Junik.

**Burimet:** deklarata Z.Z, FDH-34219; *Serb Offensive Continues :Fighting in Reka e Keqe and Junik Reported*, pasqyra e lajmeve, KIC, 1.08.1998, FDH-29388.

## Aleksandar (Lazar) Njagul

(5.09.1974, serb nga Paçeva, një fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Aleksandar me bashkëshorten Daliborken dhe djalin jetonte në Paçevë. Nga muaji prill i vitit 1997, punonte si ushtar profesionist në Ushtrinë e Jugosllavisë, në përbërje të Brigadës së Specializuar 72. Në fillim të muajit qershor të vitit 1998, e dërguan në Kosovë. Herën e fundit u lajmërua në shtëpi më 1.08.1998. Bashkëshortes i ka thënë se të nesërmen do të vinte në shtëpi. Por, një ditë më vonë, më **2.08.1998**, pjesëtarët e UJ-së i kanë lajmëruar bashkëshortes së tij se Aleksandar ka gjetur vdekjen në **Junik**. Kishte shkëlur mbi minën nëntokësore. Nga eksplodimi i saj dhe dëmtimet e rënda, ai kishte dhënë shpirt pas disa minutash. Aleksandar u varros më 4.08.1998, në varrezat e fshatit Dobrica, komuna e Alibunarit.

**Burimet:** deklarata D.Nj, FDH-26216; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 49; SMIP, *Teroristički...*, III, 979.

## Miomir (Radovan) Stojanović

(26.12.1955, serb nga Peja/Peç, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

## Elvis (Slobodan) Šunjević

(13.04.1969, boshnjak nga Rijeka, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

## Nenad (Vitimir) Belošević

(21.09.1974, serb nga Cerkolezi/Crkolez, komuna e Istogut/Istok, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të shkollës së mesme të punëve të brendshme, Elvizi u punësua në Sekretariatit e Punëve të Brendshme të Pejës/Peç, në qershor të vitit 1988. Punonte së bashku me Nenad Belošević, një oficer tjetër policie, i cili e kishte të mbaruar trajnimin për njësitet speciale policore. Miomir Stojanović punonte në Ndërmarrjen Hekurdhore Transportuese *Beograd*, njësia punuese në Pejë/Peç. Nga maji i vitit 1981, Miomiri ka qenë pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Serbisë. Në datën **2.08.1998**, në mëngjes, Elvizi, Nenadi dhe Miomiri gjendeshin në postbllokun policor në fshatin **Prilep**. Pjesëtarët e UÇK-së e kanë sulmuar postbllokun nga ora 10:00. Elvizi u qëllua menjëherë për vdekje, ndërsa Miomiri vetëm u plagos. Nenadi u nis që ta tërhiqte trupin e Elvisit, por e qëlluan me pushkë snajperi në gilcë. Nenadi pësoi nga gjakderdhja e rëndë vdekjeprurëse në rrugë e sipër për në spital. Një ditë më vonë, më 3.08.1998, e varrosën në varrezat e Cerkolezit/Crkolez. Miomiri ndërroi jetë nga plagët e rënda më **26.08.1998**, përderisa gjendej për shërim në AMU.

**Burimet:** deklarata G.B, FDH-30948; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 14, 67, 76; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832 SMIP, *Teroristički...*, III, 936; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109,110; *Dnevnik od 29. jula do 4. avgusta*, Ilustrovana politika, FDH-31199.

## Rexhep (Brahim) Kadrijaj

(17.06.1974, shqiptar nga Rastavica, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Rexhepi u bë pjesëtar i UÇK-së më 10.04.1998. Ka shkuar disa herë në Shqipëri për të transportuar armatime për UÇK-në në Kosovë. Në datën **2.08.1998**, Rexhepi u plagos rëndë në **Rastavicë/Rastavica**, te vendi i quajtur *Lugu e Mullinit/Dolina mlinova*. Edhe pse e çuan me urgjencë në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić, ai dha